

Sorenseni vjen në Prishtinë, theksohet rëndësia e fillimit të diskutimeve të zbatimit të marrëveshjes së Ohrit



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## KRYEZIU: LV-ja PO PËRGATITET PËR ZGJEDHJET E AFËRTA GJATË KËTIJ VITI APO EDHE PËR ATO TË 2026-s



Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës, (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se, siç duket, Lëvizja Vetëvendosje, pasi nuk arriti ta sigurojë shumicën për një qeveri stabile me mandat të plotë, pas refuzimit nga LDK-ja, po pozicionohet të

qëndrojë në opozitë ose të shkojë në zgjedhje të reja. "Pra, LV-ja po përgatitet për zgjedhjet e afërta gjatë këtij viti, apo edhe për zgjedhjet e vitit 2026. E, për më tepër, nëse Kosova shkon në zgjedhje të vitit 2026, si rezultat i mungesës së

votave për zgjedhjen e presidentit, atëherë Vetëvendosja apo Albulena Haxhiu, nëse mban postin e kryetares së Kuvendit, automatikisht do ta ushtrojë për disa muaj edhe detyrën e presidentes", ka thënë Kryeziu


**VEPRIMTARI SALI BISLIMI VENDOS POSTERIN E THAÇIT NË QYTETIN DELÉMONT TË ZVICRËS** F. 3



**NJË DITËLINDJE TJETËR E PRESIDENTIT THAÇI NË HAGË. PO TË PRESIM TË GJITHË KRAHËHAPUR** F. 3



### AKTUALE



**SHBA-JA SYNON MBYLLJEN E MCC-së** F. 2

**HARADINAJ ME UDHËHEQJEN E OVLUÇK-SË: SHTETI KA DETYRIM MORAL E INSTITUCIONAL NDAJ LUFTËTARËVE** F. 6

**AMBASADORI BRITANIK: KOSOVA KA NEVOJË URGJENTE PËR NJË KUVEND DHE QEVERI FUNKSIONALE** F. 6

### EKONOMI



**PËRURORHET URA E RE NË ROGOVË TË HASIT** F. 8

**MURATI THOTË SE, SIPAS FMN-së, KOSOVA KËTË VIT DO TA KETË RRRITJEN EKONOMIKE MË TË SHPEJTËN NË EVROPË** F. 8

### SPORT



**KATËR KLUBE SYNOJNË KUPËN NË HENDBOLL** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVIÇË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# ShBA-ja synon mbylljen e MCC-së

UASHINGTON, 24 PRILL - Departamenti për Efikasitet të Qeverisë (DOGE) në Shtetet e Bashkuara, që udhëhiqet nga Elon Musk, raportohet se po i jep fund punës së Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), sipas incizimit të një takimi të stafit dhe të një emaili dërguar stafit që i ka parë “Reuters”. MCC-ja është krijuar për ta zvogëluar varfërinë dhe për ta nxitur rritjen ekonomike në mbarë botën. Kosova është pjesë e shteteve me të cilat kjo agjenci bashkëpunon. Lëvizja për mbylljen e MCC-së është pjesë e përpjekjeve të presidentit amerikan, Donald Trump, dhe këshilltarit të tij, Musk, për të tkurrur qeverinë federale, duke argumentuar se paratë e taksapaguesve amerikanë po shpërdorohen. Stafit të MCC-së i është thënë gjatë një mbledhjeje të mërkurën se të gjitha programet e agjencisë do të mbyllën dhe numri i stafit do të minimizohet, sipas

incizimit të këtij takimi. “Ndihma e huaj nuk është prioritet për administratën, prandaj puna e MCC-së duhet të përfundojë”, i tha stafit Kye Kim, zyrtare e lartë në MCC. Zyrtarët nga DOGE kanë shkuar në agjenci javën e kaluar dhe kanë nisur bisedimet me udhëheqjen, të cilët po tentojnë ta shpëtojnë agjencinë, tha Kim. MCC-ja nuk është përgjigjur në kërkesën e “Reuters”-it për koment. Politico e para raportoi për këtë lëvizje, duke cituar një email që i ishte dërguar stafit të agjencisë të martën, të cilën “Reuters” më pas e ka parë. Në email, afër 300 punëtorëve u jepet afat deri në 29 prill nëse duan të zgjedhin pensionin e hershëm vullnetar ose të japin dorëheqje dhe të marrin pagë deri në shtator – në të kundërtën do të përballen me pushim administrativ. Administrata e Trumpit ka zhbërë agjencinë kryesore të ndihmës së Uashingtonit, USAID, e cila



administronte rreth 40 miliardë dollarë ndihma në vit. MCC-ja, që është krijuar nga Kongresi amerikan me mbështetjen e republikanëve dhe demokratëve më 2004, ka një buxhet vjetor prej rreth 900 milionë dollarësh. Agjencia bashkëpunon me shtetet në zhvillim në projekte sikurse përmirësimi i furnizimeve me energji elektrike për biznese dhe

në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, në mënyrë që fermerët të mund të dërgojnë mallrat e tyre në treg, thuhet në ueb-faqen e MCC-së. MCC-ja ka bashkëpunuar me Kosovën që nga viti 2016. Prillin e vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës dhe MCC-ja lansuan zbatimin e programin kompakt, që ka për synim ofrimin e zgjidhjeve për energji të pastër.

Ky program kap vlerën prej 202 milionë dollarësh nga MCC-ja dhe 34.7 milionë të tjera si kontribut i Kosovës. Marrëveshjet kompakt janë grante pesëvjeçare dhe MCC-ja u ka lëshuar programe të tilla shteteve që plotësojnë kriteret për kualifikim për programe të tilla. Kosova e kishte arritur marrëveshjen me MCC-në për programin kompakt më 2022. Projekti kryesor i programit është ai i ruajtjes së energjisë. Përmes tij, Kosova është paraparë që të ketë rezerva të energjisë përmes baterive të kapacitetit të lartë prej 170 megavatësh. Këto bateri do të mundësojnë sigurimin e rezervave prej rreth 347 megavatësh në orë. MCC-ja po ashtu ka pasur edhe programe të tjera për zhvillimin ekonomik në Kosovë në vlerë prej 50 milionë dollarësh. Kjo agjenci e ShBA-së po ashtu ka ofruar bursa për shkollimin e grave në fushën e energjisë.

# Schmidt e pezullon financimin buxhetor për partinë e Dodikut

SARAJEVË, 24 PRILL - Përfaqësuesi i lartë në Bosnjë-Hercegovinë, Christian Schmidt, ka marrë vendim për t'i pezulluar pagesat nga buxheti në të gjitha nivelet në Bosnjë për Aleancën e Socialdemokratëve të Pavarur, e cila udhëhiqet nga Millorad Dodiku, dhe për partinë politike Sërpska e Bashkuar, e cila është partnere në koalicion me partinë e Dodikut në entitetin Republika Sërpska. Duke folur në Sarajevë, Schmidt tha të enjten se pezullimi i financimit vlen për buxhetet në të gjitha nivelet - nga ai shtetëror, i entiteteve deri te ai komunal - duke theksuar se “veprimet kundër Marrëveshjes së Dejtonit kanë pasojë dhe se ai do ta



rishqyrtojë vendimin e tij pasi ato të ndalen”. “Të gjitha fondet për këto parti, në të gjitha nivelet e

pushtetit, do të pezullohen dhe do të ridrejtohen në një llogari të veçantë në Bankën Qendrore të

BeH”, tha Schmidt. Përfaqësuesi i lartë i bashkësisë ndërkombëtare në Bosnje ka kompetenca, të cilat janë konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, për të imponuar ligje dhe për të shkarkuar zyrtarë. Ai, gjithashtu, e ka ndryshuar Kodin Penal të Bosnjës dhe ka përcaktuar që vendimet e tij janë të detyrueshme. Dodik, së bashku me kryetarin e Kuvendit të RS-së dhe liderin e partisë Sërpska e Bashkuar, Nenad Stevandić, si dhe me kryeministrin e RS-së, Radovan Visković, dyshohen për sulm ndaj rendit kushtetues, në një hetim që Prokuroria e Bosnjës po e zhvillon

që nga fundi i vitit të kaluar. Në mars u lëshuan fletarrestime qendrore ndaj tyre, pasi ata nuk iu përgjigjën ftesës për t'u marrë në pyetje. Kjo do të thotë që secila nga gjithsej 16 agjencitë policore në të gjitha nivelet e pushtetit në Bosnje duhet t'i arrestojë ata, gjë që deri më sot nuk është bërë. Schmidt theksoi se me vendimin që ka imponuar, synon t'i mbështesë përpjekjet e institucioneve të Bosnjës për t'iu kundërvënë “sulmeve flagrante të koalicionit qeverisës të RS-së, të udhëhequr nga SNSD-ja dhe Sërpska e Bashkuar, ndaj parimeve themelore të Marrëveshjes së Dejtonit dhe rendit kushtetues-juridik të Bosnjës”.

# Rusia sulmon Kievin me raketa dhe dronë, vret 9 persona dhe plagos dhjetëra të tjerë

KIEV, 24 PRILL - Të paktën nëntë njerëz janë vrarë si pasojë e sulmeve të Rusisë me dronë dhe raketa në Kiev, thanë zyrtarët ukrainas të enjten. Shërbimi Shtetëror i Emergjencave i Ukrainës tha se dhjetëra njerëz janë plagosur, përfshirë gjashtë fëmijë, gjatë sulmeve të natës. Sulmi gjatë natës - një nga më të mëdhenjtë në muajt e fundit - ndodhi vetëm disa orë pasi Shtëpia e Bardhë ua paraqiti zyrtarëve ukrainas një ultimatum në lidhje me një propozim amerikan për t'i dhënë fund pushtimit të Ukrainës nga Rusia, i cili nisi para më shumë se tri

vjetëve. Përpjekjet e Perëndimit për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë - apo qoftë edhe për një armëpushim të përkohshëm - kanë ngecur ditët e fundit, pasi Rusia nuk po jep shenja se do t'i pakësojë sulmet e saj, ndërkohë që Ukraina kundërshton propozimet amerikane. Ministrat e Jashtëm dhe diplomatët e lartë duhej të takoheshin në Londër më 23 prill për bisedime rreth luftës. Por, takimet humbën disi rëndësinë pasi sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, u tërhoq në çastin e fundit. Ky vendim, sipas raportimeve,



erdhi pasi presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, nuk e pranoi një propozim amerikan që Uashingtoni ta njohë zyrtarisht gadishullin e Detit të Zi, Krimenë, si pjesë të Rusisë. “Rusia ka kryer sulm të kombinuar masiv në Kiev”, tha Shërbimi i Emergjencave në Telegram. Ndërtesa banimi kanë pësuar dëme, ndërsa “kërkimet për njerëz nën rrënoja janë duke vazhduar”, thuhet në njoftim. Ndërkohë, kryetari i bashkisë së Harkivit, Ihor Terekhov, tha se edhe qyteti i tij në verilindje të Ukrainës u sulmua nga Rusia, duke thënë në Telegram se shtatë raketa goditën qytetin.

# VEPRIMTARI SALI BISLIMI VENDOS POSTERIN E THAÇIT NË QYTETIN DELÉMONT TË ZVICRËS

PRISHTINË, 24 PRILL - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten ka mbushur 57 vjet. Me rastin e ditëlindjes së tij, veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton në Zvicër, ka bërë një akt simbolik e domethënës. Ai zyrtar e tij në qytetin Delémont ka vendosur posterin e Thaçit me mbishkrimin: "I angazhuar për liri: Hashim Thaçi një lider për ta liruar". "Urime ditëlindja president Thaçi! Në rastin e ditëlindjes se tij një poster për disa ditë në sheshin e qytetit Delémont, ku me prezencë na nderoi edhe deputeti kantonal i kantonit Jura miku im, Raoul Jeaggi. Liria presidentit Thaçi promovon bashkëjetesën në paqe mes komuniteteve në Ballkan. Një drejtësi e vonuar është një padrejtësi. Gjykata Speciale në mungesë të provave ajo prolongoi procesin duke ia vazhduar paraburgimin presidentit Thaçi për të vetmin qëllim për

t'i krijuar dhimbje dhe mërzi në proces, një njeriu që me gjithë qenien e tij mbrojti një popull nga padrejtësia dhe barbaria dhe futi Kosovën e lirë në shekullin e ri", ka shkruar Bislimi në "Facebook". Ai ka thënë se tani jemi në fund të procesit ku liria e presidentit është e domosdoshme për t'i dhënë forcë rajonit, për t'i zgjidhur problemet e së kaluarës dhe ndërtimin e të ardhmes në paqe dhe demokraci. "Miku im deputeti kantonal Raoul Jeaggi na nderoi sot me prezencë dhe solidaritet për presidentin! Me këtë poster do të udhëtojë në qendrat evropiane. Në Parlamentin Evropian, Zvicëran, në Këshillin e Evropës dhe në Hagë! President të presim në mesin tonë për t'i dhënë vendit rëndësinë, demokracinë dhe pajtimin. Edhe 100. Urime!", ka shkruar veprimtari Sali Bislimi.



## NJË DITËLINDJE TJETËR E PRESIDENTIT THAÇI NË HAGË. PO TË PRESIM TË GJITHË KRAHËHAPUR

PRISHTINË, 24 PRILL - Ish-presidenti Hashim Thaçi të enjten ka mbushur 57 vjet. Edhe në këtë ditëlindje Thaçi ndodhet në Hagë, ku po përballlet me një proces të padrejtë për luftën e UÇK-së. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, derisa ka uruar ish-presidentin Hashim Thaçi për ditëlindjen, ka thënë se ai vazhdon t'i japë Kosovës "dinjitet dhe krenari", ndërsa tha se në Hagë po qëndron "padrejtësisht i mbyllur". "Urime ditëlindjen, President! Në 57-vjetorin e lindjes, për herë të pestë padrejtësisht i mbyllur mes katër mureve në Hagë, Hashim Thaçi vazhdon t'i japë Kosovës dinjitet dhe krenari - ashtu siç ka bërë



për më shumë se dy të tretat e jetës së tij. Prandaj, sot festojmë,

bashkë me të dhe për të - studentin e demonstratave,

ushtarin e lirisë dhe udhëheqësin historik. Për simbolin e pavarësisë dhe vendimeve të mëdha - që ndryshuan përgjithmonë fatin tonë. Mos u vono më shumë, President - po të presim të gjithë, krahëhapur dhe me zemrat plot", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Thaçin për ditëlindje e ka uruar edhe Bedri Hamza, kryetar i Mitrovicës. "Një ditëlindje tjetër e presidentit në Hagë. Një ditëlindje tjetër larg familjes, miqve dhe Kosovës, atje ku tani po peshohet historia jonë me padrejtësitë mbi ata që i bartën proceset kryesore nëpër të cilat kaluam si vend e popull. Gëzuar ditëlindjen, President! U

gëzofshim sa më shpejt të gjithë, ju, ne e Kosova, me lirin dhe rikthimin tuaj në mesin tonë!", ka shkruar Hamza në "Facebook". Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Taulant Balla, e ka uruar për ditëlindje ish-presidentit e Kosovës, Hashim Thaçi. Duke e postuar një fotografi nga Haga, ai ka shprehur edhe një urim të veçantë. "Gëzuar ditëlindjen president Thaçi! Uroj sa më shpejt të takojmë në Kosovë e në Shqipëri", ka shkruar Balla. Ish-presidenti Thaçi ka marrë urime të shumta edhe nga bashkëpartiakët e tjerë, ish-kryetar komunash e mbështetës të tij.



# KRYEZIU: LV-ja PO PËRGATITET PËR ZGJEDHJET E AFËRTA GJATË KËTIJ VITI APO EDHE PËR ATO TË 2026-s

Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës, (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se, siç duket, Lëvizja Vetëvendosje, pasi nuk arriti ta sigurojë shumicën për një qeveri stabile me mandat të plotë, pas refuzimit nga LDK-ja, po pozicionohet të qëndrojë në opozitë ose të shkojë në zgjedhje të reja. “Pra, LV-ja po përgatitet për zgjedhjet e afërta gjatë këtij viti, apo edhe për zgjedhjet e vitit 2026. E, për më tepër, nëse Kosova shkon në zgjedhje të vitit 2026, si rezultat i mungesës së votave për zgjedhjen e presidentit, atëherë Vetëvendosja apo Albulena Haxhiu, nëse mban postin e kryetares së Kuvendit, automatikisht do ta ushtrojë për disa muaj edhe detyrën e presidentes”, ka thënë Kryeziu.

EPOKA  
ERE

## Mal QORRAJ

Prishtinë, 24 prill - Edhe në përpjekjen e pestë, të mërkurën, deputetët kanë dështuar ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës. Kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje, partisë fituese të zgjedhjeve, Albulena Haxhiu, dështoi të zgjidhej kryetare e Kuvendit. Opozita e kundërshtoi përsëri emërimin e Haxhiut. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, njoftoi se seanca e ndërprerë do të vazhdojë sot (e premte) në orën 11:00. Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës, (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se posti i kryetarit të Kuvendit nuk është as teknik, as neutral, është një pozitë politike me peshë të madhe dhe

përgjegjësi të qarta brenda funksionimit parlamentar. “Historikisht, zgjedhja e kryetarit ka qenë gjithmonë rezultat i marrëveshjeve politike mes koalicioneve qeverisëse, i shumicës parlamentare, jo një vendim apo imponim i njëanshëm. Nuk mund t’i kërkojë votat e opozitës pa asnjë marrëveshje e pastaj ta akuzosh për bllokim, vetëm pse nuk ta voton kandidatin e propozuar. Kjo nuk është as përgjegjësi politike, as kulturë demokratike. Është arrogancë politike dhe injorim i rolit që ka opozita në një sistem parlamentar”, ka thënë Kryeziu.

Ai ka shtuar se sa iu përket argumenteve si “kush ka marrë më shumë vota nga qytetarët” apo “kush është

kandidati dhe çka përfaqëson”, janë pa asnjë peshë në këtë fazë. “Vota për kryetarin e Kuvendit është përgjegjësi e deputetëve dhe varet nga marrëveshjet politike që sigurojnë shumicën, jo nga retorika publike”, ka deklaruar Kryeziu. Ai ka theksuar se, siç duket, Lëvizja Vetëvendosje, pasi nuk arriti ta sigurojë shumicën për një qeveri stabile me mandat të plotë, pas refuzimit nga LDK-ja, po pozicionohet të qëndrojë në opozitë ose të shkojë në zgjedhje të reja. “Nuk po synon të formojë një qeveri me minimumin prej 61 votash, pasi një qeveri e tillë do të ishte e paqëndrueshme dhe e rrezikuar nga fillimi. Nga ana tjetër, nuk po do as të rrezikojë një tjetër përpjekje të dështuar për koalicion, kësaj

radhe me PDK-në, e cila mund të refuzojë njëjtë siç bëri LDK-ja. Pra, me shumë gjasë do të shmangë PDK-në si mundësi për bashkëqeverisje, së paku në këtë situatë dhe do të provokojë zgjedhje të reja. Por, duke u siguruar për të ruajtur një pjesë të kontrollit institucional, siç është posti i kryetarit të Kuvendit”, ka thënë ai.

Kryeziu ka theksuar se asnjë veprim më tutje për të siguruar numra dhe konsensus, në një farë mënyre arsyeton këmbënguljen për përzgjedhjen e Albulena Haxhiut si kandidate për kryetare të Kuvendit. “Nga njëra anë, e njohur për besnikëri ndaj linjës së LV-së dhe liderit të saj; nga ana tjetër, për qëndrimet e saj të ashpra ndaj subjekteve politike kundërshtare. Ky veprim politik për të mos propozuar një kandidat konsensual përputhet me këtë strategji: një figurë që nuk synon kompromise, por që do ta përfaqësojë vijën e fortë të partisë në skenën parlamentare dhe do të tentojë të ndikojë në efikasitetin e një qeverie alternative që nuk pritët të jetë e qëndrueshme në numra, as shumë jetëgjatë në kohë. Me pikëpyetje të mëdha, nëse një qeveri e atillë do të arrinte

të formohej nga subjektet e tjera?”, është shprehur ai, duke shtuar se: “Pra, LV-ja po përgatitet për zgjedhjet e afërta gjatë këtij viti, apo edhe për zgjedhjet e vitit 2026. E për më tepër, nëse Kosova shkon në zgjedhje të vitit 2026, si rezultat i mungesës së votave për zgjedhjen e presidentit, atëherë Vetëvendosje apo Albulena Haxhiu, nëse mban postin e kryetares së Kuvendit, automatikisht do ta ushtrojë për disa muaj dhe detyrën e presidentes”, ka thënë Kryeziu.

Ai ka thënë se në të dy situatat e shkuarjes në zgjedhje, LV-ja po kalkulon se përsëri do të jetë subjekti i parë favorit për të fituar. “Për atë, nuk po ju ngutet ta marrin udhëheqjen e qeverisë, pa një stabilitet në numra e me mandat të ri dhe të qartë, për të vazhduar me legjitimitet të plotë. Sepse diçka është e sigurt nëse shkojmë në zgjedhje, dhe nëse nuk ndryshojnë rezultatet apo do të ndryshojnë pak, shumë do t’i ndryshojnë qëndrimet dhe mundësitë e bashkëpunimit mes subjekteve politike”, ka thënë Kryeziu.

Ai ka thënë se shkuarja në zgjedhje si e vetmja mundësi për dalje nga një situatë si kjo që po vazhdon tregon se asnjëra nga këto parti politike

# PSE HAXHIU ËSHTË MOLLË SHERRI PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT?



PRISHTINË, 24 PRILL - Emri i saj u hodh në votim tri herë, por Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje (LV) në asnjërin rast nuk i mori 61 votat e nevojshme për t'u bërë kryeparlamentare e Kosovës. Haxhiu konsiderohet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) si figurë përçarëse, ndërkaj Lindhja Demokratike e Kosovës (LDK) refuzon të votojë çdo emër të propozuar nga fituesja e zgjedhjeve parlamentare, LV-ja. A është Haxhiu pengesë apo pretekst për moskonstituimin e Kuvendit të Kosovës?

Besar Gërgi nga Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (GSLP) i sheh të dyja këto si motive të mundshme. "Nga njëra anë, ato [partitë politike] duket se kanë një lloj rehatie me situatën, dhe nuk iu bëhet vonë për konstituimin e legjislaturës së nëntë. Por, nga ana tjetër, shihet se kanë edhe një mospëlqim për emrin e caktuar, të zonjës Haxhiu", thotë Gërgi për Radion Evropa e Lirë. Haxhiu nuk arriti të marrë më shumë se 57 vota të deputetëve në Kuvend. Të domosdoshme janë edhe votat e deputetëve të partive që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. PDK-ja dhe AAK-ja kërkojnë që LV-ja të propozojë një emër tjetër, që paraqet figurë unifikuese, në mënyrë që t'i marrë votat e deputetëve të tyre.

## Për PDK-në dhe AAK-në, deputetja e LV-së, Albulena Haxhiu, është figurë përçarëse për postin e kryeparlamentares. Por, a është emri i Haxhiut pengesë apo pretekst për moskonstituimin e Kuvendit të Kosovës?

### Qëndrimet e partive për Haxhiun

LV-ja refuzon ta ndryshojë propozimin e saj, duke arsyetuar se Haxhiu është deputetja më e votuar në Kuvend, me 125 mijë vota. "Pesha politike, legjitimiteti i zonjës Albulena Haxhiu për të qenë kryetare e Kuvendit është i pakontestueshëm", u tha gazetarëve deputetja e LV-së, Mimoza Kusari Lila, pas ndërprerjes së seancës konstituive të Kuvendit të mërkurën. Kreu i PDK-së, Memli Krasniqi, tha të hënën se partia e tij nuk do ta votojë asnjëherë Haxhiun për kryetare të Kuvendit, për shkak se "ajo është simbol i dështimit të qeverisë në mandatin e kaluar katërvjeçar". "Krejt mandatin e ka

pasur të përcjellë me skandale të ndryshme, prej zhdukjes së mostrave të Astrit Deharit e deri tek ulja e buxhetit për mbrojtjen e çlirimtarëve në Hagë", deklaroi Krasniqi. Aktivisti i LV-së, Dehari, u gjet i vdekur në një qeli burg në Prizren, në nëntorin e vitit 2016. Në dhjetorin e vitit 2022, Haxhiu, e cila ishte ministre e Drejtësisë, konfirmoi se mostrat e Deharit ishin zhdukur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore. Në vitin 2023 buxheti i ndarë nga Qeveria e Kosovës për mbrojtjen e të akuzuarve nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ishte mbi tetë milionë euro, ndërkaj, vitin e kaluar, më pak se 7 milionë euro. AAK-ja ka sugjeruar dy emra të tjerë të LV-së për kryeparlamentare: Saranda Bogujevcin dhe Shqipe Selimin.

Kjo parti e ka cilësuar Haxhiun si politikane jounifikuese. "Qasja që ka pasur zonja Haxhiu, gjuha që ka përdorur ndaj opozitës është konfliktuoze, kjo ka qenë arsyeja [për mosvotimin e saj nga AAK-ja]", thotë për Radion Evropa e Lirë deputetja e kësaj partie, Time Kadrijaj. Për dallim nga partitë e tjera, LDK-ja ka thënë se nuk do ta votojë asnjë kandidat të propozuar nga LV-ja për kryetar të Kuvendit.

### "Haxhiu, shkak dhe pretekst për ngecje"

Edhe Gërgi nga GSLP-ja mendon se Haxhiu, gjatë angazhimit të saj politik si deputete dhe si ministre e Drejtësisë, ka përdorur gjuhë të ashpër ndaj kundërshtarëve politikë. Kjo është një nga arsyet, sipas tij, pse PDK-ja dhe AAK-ja kërkojnë një emër tjetër nga LV-ja, i cili do të ishte i pranueshëm si kryeparlamentar edhe për partitë e tjera. "Për shembull, mund ta krahasojmë me kandidatit e Vetëvendosjes në legjislaturën e kaluar, Glauk Konjufca, i cili arriti të marrë disa vota edhe nga opozita", thotë Gërgi. Megjithatë, ai shpreh mendimin se mospajtimet e partive politike lidhur me emrin e Haxhiut si kryeparlamentare po shfrytëzohen edhe si pretekst nga palët për ta zvarritur konstituimin e Kuvendit.

### "Marshimi i heshtur drejt zgjedhjeve të reja"

Gërgi thekson se përfundimi i këtij procesi e hap rrugën për formimin e qeverisë së re. Për ta bërë këtë, LV-ja, si fituese e zgjedhjeve, do të ketë 15 ditë kohë. Në rast se dështon, atëherë presidentja e Kosovës zgjedh partinë që ia dëshmon se i ka 61 vota për formimin e ekzekutivit. Shtegdalje nga situata, sipas Gërgit, do të ishte formimi i një qeverie të qëndrueshme nga LV-ja, me një nga partitë e mëdha, PDK-në ose LDK-në. Marrëveshja për një qeveri të tillë, siç vlerëson ai, nuk duket as në horizont, ndërkaj për formimin e një qeverie të brishtë nuk kanë vullnet politik as LV-ja në njërin anë, dhe as PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja në anën tjetër. "Fatkeqësisht, po shohim një lloj ngathtësie nga elita politike e vendit për të formuar një qeveri, dhe ne po marshojmë në mënyrë të heshtur drejt zgjedhjeve të reja [të parakohshme]", vlerëson Gërgi. Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës, e cila nisi më 15 prill, është ndërprerë pesë herë. Sipas Rregullores së Kuvendit, ajo mund të vazhdojë jo më larg se 48 orë nga ndërprerja, pa kufizime se sa vazhdimet mund t'i ketë. Pa zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit dhe nënkryetarëve të tij, procesi i konstituimit të këtij institucioni ligjvënës nuk konsiderohet i përmbyllur.

nuk po merr vendime apo qëndrime që kalojnë përtej elektoratit të vet, për të mos thënë interesave dhe grupeve të ngushta brenda subjekteve të tyre. "Vendimmarrja dhe roli i tyre në konsolidimin e

institucioneve dhe qeverisjen e vendit nuk është i bazuar mbi interesin qytetar por - sipas deklaratave të tyre - mbi interesin e votuesve të tyre. Kjo është në kundërshtim me thelbin dhe vlerat demokratike:

pse mbahen zgjedhjet, pse zgjidhet një deputet, apo pse një parti politike garon në zgjedhje dhe merr përgjegjësi për të bërë politikë - qoftë nga pozita, qoftë nga opozita. Sidomos deputeti, por edhe

partia politike nuk është përgjegjëse dhe nuk duhet të jetë llogaridhënëse vetëm ndaj votuesit të vet, por ndaj të gjithë qytetarëve - edhe ndaj atyre që s'kanë votuar fare, apo që kanë votuar ndryshe nga

oferta e tyre. Krijimi i politikave, ligjeve dhe vendimeve nuk janë dhe nuk ndikojnë vetëm elektoratin e tyre, por kanë peshë në jetën e të gjithë qytetarëve", ka thënë Kryeziu.

## Haradinaj me udhëheqjen e OVLUÇK-së: Shteti ka detyrim moral dhe institucional ndaj luftëtarëve

PRISHTINË, 24 PRILL - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim udhëheqjen e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, kryesuar nga Hysni

Gucati, me të cilët ka ndarë shqetësimet për kategorinë më meritore për lirinë e Kosovës. “Krerët e luftëtarëve të lirisë i sigurova se siç kam qenë përherë pranë tyre, unë

dhe Aleanca mbetemi në mbështetje të kërkesave të tyre legjitime, në funksion të së drejtës dhe dinjitetit që u takon. Shteti i Kosovës i ndërtuar mbi sakrificën e

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka detyrim moral e institucional ndaj luftëtarëve, të rënë dhe familjeve të tyre”, ka thënë Haradinaj pas takimit.



# SORENSENI VJEN NË PRISHTINË, THEKSOHET RËNDËSIA E FILLIMIT TË DISKUTIMEVE TË ZBATIMIT TË MARRËVESHJES SË OHRIT

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 PRILL - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen, kreu një vizitë të paparalajmëruar në Kosovë të enjten, ku tha se do të udhëtojë për në kryeqytetin serb, Beograd.

Në vizitën e tij të dytë në Prishtinë, Sorenseni u takua me kryenegociatorin e Kosovës për dialogun, Besnik Bislimi.

I pyetur rreth vizitës, Sorenseni tha shkurtimisht për gazetarë se “jemi duke punuar” dhe se ndodhej në Kosovë ashtu siç ia kërkon detyra si i dërguar i bllokut. “Është një vizitë normale, siç mund ta shihni. Jam i lumtur që jam këtu dhe tani do të shkoj në Beograd, pastaj do të kthehem në Bruksel”, tha ai.

Qeveria në detyrë e Kosovës njoftoi për media se Bislimi dhe Sorenseni biseduan rreth zbatimit të marrëveshjeve të ndryshme të nivelit teknik. “Zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, priti në takim përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Peter Sorensen. Ky ishte takimi i dytë



mes tyre në Prishtinë, pas atij të mbajtur muajin e kaluar. Biseduan rreth zbatimit të marrëveshjeve të ndryshme të nivelit teknik, e më tej u theksua edhe rëndësia e fillimit të diskutimeve të zbatimit të marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit Implementues të Ohrit në kuadër të procesit të dialogut. Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi emisarin Sorensen për takimin e bisedën si dhe bashkëpunimin mes tyre”, ka njoftuar qeveria në detyrë.

Paraprakisht, Sorenseni ishte takuar me komandantin e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, Enrico Barduani. KFOR-i shkroi në “Facebook” se shkëmbyen mendime lidhur me zhvillimet e sigurisë në mbarë rajonin.

Kjo ishte vizita e dytë e Sorensenit në Kosovë prej se e mori detyrën në fillim të shkurtit dhe erdhi në një kohë kur Kosova nuk po arrin ta konstitujë Kuvendin dhe ta formojë qeverinë e re më shumë se dy muaj pas zgjedhjeve të 9

shkurtit.

Gjatë vizitës së tij të parë në Prishtinë në mars, Sorenseni kishte thënë se prioritet për të ishte të caktonte takime mes dy shteteve. “Dialogu është për t’u siguruar që të ketë takime. Se a do të thotë kjo kompromise apo jo, u takon palëve për ta përcaktuar”, kishte thënë Sorenseni gjatë vizitës së tij në Prishtinë në mars.

Takimi i fundit në Bruksel i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në mes të Kosovës dhe Serbisë ishte zhvilluar më 17

dhjetor të vitit të kaluar.

Shefja e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, tha në fillim të këtij muaji se BE-ja është duke i zbërthyer gabimet në dialogun e Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë në mënyrë që t’i japë gjallëri procesit të normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve fqinje. E pyetur për ngecjen e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kallasi kishte thënë se “ajo çfarë po bëjmë këtë muaj është analizimi” së bashku me Sorensenin. “Çfarë është me rëndësi për ne është normalizimi i marrëdhënieve, sepse pa to asnjëra nga to nuk mund të ecë përpara në rrugën drejt BE-së”, tha Kallasi.

Kallasi nuk dha më shumë hollësi se cilat mendon që ishin gabimet apo çfarë nuk ka shkuar deri tani në dialogun e ndërmjetësuar nga blloku.

Me gjithë dialogun e zhvilluar ndër vite dhe nënshkrimin e marrëveshjeve, procesi ka ngecur dhe tensionet janë rritur. Me ndërmjetësimin e BE-së, në vitin 2023 Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve. Por, prej atëherë, blloku i ka kritikuar të dyja vendet se nuk e kanë zbatuar marrëveshjen pavarësisht se ajo është e detyrueshme për to.

## AMBASADORI BRITANIK: KOSOVA KA NEVOJË URGJENTE PËR NJË KUVEND DHE QEVERI FUNKSIONALE



PRISHTINË, 24 PRILL - Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar as në tentativën e pestë. E propozuara për kryetare të Kuvendit nga Vetëvendosja, Albulena Haxhiu, nuk i ka marrë votat e nevojshme as të mërkurën. Kjo situatë ka shqetësuar jo vetëm qytetarët

në vend, por edhe ambasadat e huaja.

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Jonathan Hargreaves, ka deklaruar se Kosova ka nevojë urgjente për një Kuvend dhe qeveri funksionale. “Më shumë se dy muaj pasi populli i Kosovës

votoi në zgjedhje, Kosova ka nevojë urgjente për një Kuvend dhe qeveri funksionale. Populli ka të drejtë të presë që liderët e tyre politikë të punojnë së bashku në interesin kombëtar”, ka thënë diplomati britanik për “Klanin”.

## Kolonel Beton Retkoceri akreditohet atashe i ri i Mbrojtjes në Japoni

PRISHTINË, 24 PRILL - Me rastin e akreditimit të tij atashe i mbrojtjes në Japoni, kolonel Beton

Retkoceri realizoi vizitat e para zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes së Japonisë. Akredimi i kolonel

Retkocerit atashe i mbrojtjes i Republikës së Kosovës në Japoni forcon më tej bashkëpunimin e

deritashëm ndërmjet Kosovës dhe Japonisë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



## Albini nuk është kryeministër

PRISHTINË, 24 PRILL - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se Albin Kurti nuk është kryeministër. Sipas saj, me gjithë votat që ka marrë, ai në këtë moment është vetëm një nga 120 deputetët i cili me konsistencë po vazhdon t'i shkelë ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Edhe nëse dikush përpiket t'i amnistojë duke thënë se 'Ligji për Qeverinë s'është ligj i

hartuar mirë', ne e kemi Nenin 72 të Kushtetutës, i cili është i prerë: 'Deputeti nuk mund të mbajë post ekzekutiv'. Kjo nuk është çështje teknike. Kjo është shkelje e rendit kushtetues, marrje peng e institucioneve dhe shkelje e betimit të dhënë në Kuvend. Po e përsëris: Albin Kurti nuk është më kryeministër, as Albulena Haxhiu, as Hekurani Murati, as të tjerët nuk janë

më ministra - janë deputetë që po vazhdojnë të sillen si qeveri, po i mashtrojnë qytetarët, po i shkelin ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës", ka shkruar Bajrami në "Facebook". Ajo i ka bërë thirrje Kurtit t'i bëjë votat në Kuvend dhe të kthehet me mandat të ri në zyrë. "Z. Kurti, bëji votat në Kuvend! Kthehu në zyrë me mandat të ri, ose eja në

Kuvend dhe rri si deputet. Përndryshe, me këto sjellje dhe veprime je duke vazhduar me rrënim të rendit kushtetues. Kushtetuta nuk është alternativë - është detyrim! Abuzimi në emër të votës, abuzimi me pushtet dhe shkelja e ligjeve dhe e Kushtetutës nuk duhet të normalizohen. Prokuroria duhet të veprojë - tani!", ka thënë Bajrami, duke shtuar se



LDK-ja shumë shpejt do të bëjë kallëzim penal për këtë çështje.

## PARASHIKIMET PËR RITJE EKONOMIKE TË FMN-së PËR GREQINË NË TË KALUARËN DHE PËR KOSOVËN SOT



Shkruan:  
Safet GËRXHALIU

Parashikimet e FMN-së se Greqia do të ketë rritje ekonomike pozitive ndër vite e quan këtë shtet drejt falimentimit. Parametrat ekonomik në Greqi që nga viti 2003 kanë qenë mjaft shqetësues, sidomos sa i përket punësimit, investimeve të

huaja, korrupsionit, stagnimit ekonomik dhe rënies së eksporteve. Ndihamat nga BE-ja dhe konsumi apo shpenzimet dhe korrupsioni i përcjell me inflacion ishin shtyllat e vetme që funksiononin në atë kohë deri sa shteti grek nuk u gjend para falimentimit, dhe u nevojiti ndërhyrje emergjente e BE-së dhe institucioneve tjera ndërkombëtare për ta shpëtuar! FMN-ja dilte edhe atëherë me parashikime për rritje ekonomike në Greqi dhe se çdo gjë në rregull!?! Në Kosovë misioni i FMN-së bazohet vetëm në monitorimin e stabilitetit bankar dhe ato makro-fiskal që është qasje e gabuar.

Kosova ka nevojë për një monitorim horizontal ku analizohen edhe parametra të tjerë ekonomik, dhe aty të jepen rekomandime dhe parashikime reale për rritje ekonomike. Kosova sot është nën masa apo sanksione ekonomike nga Bashkimi Evropian që dëmtojnë në aspektin ekonomik, politik, social, integrues dhe psikologjik. Kosova ka mungesë të stabilitetit politik që e ngulfat zhvillimin dhe perspektiven ekonomike. Kosova ka përqindjen më të ultë të investimeve të huaja duke anashkaluar diasporën. Kosova është shtet i varur nga importi ku në vitin 2024 kemi importuar mbi 6.3 miliardë euro dhe krahas kësaj kemi importuar edhe inflacion të

heshtur ku jetën e qytetarëve e bënë më shtrenjtë se sa në Evropë. Nga Kosova po ikin të rinjtë dhe atë në heshtje që është një ikje më e rrezikshme sesa egzodini. Që nga fillimi i liberalizimit Kosovën e kanë braktisur 170.000 qytetarë. Sektori privat është i ballafaquar me presione politike të pa para dhe me mungesë të dialogut publiko privat. Korrupsioni dhe tenderët një burimor janë rekord dhe po vazhdojnë të rriten. Projektet publike dhe implementimi i tyre janë në pikën kritike dhe po ngufatin sektorin privat. Rritja e kredive bankare është shqetësuese, kreditë konsumuese janë në rritje të madhe dhe kur i shtohet fakti i

shfrytëzimit të overdraftit nga qytetarët e paraqet realitetin ekonomik të Kosovës. Kur e analizoni pagën minimale, pagën mesatare dhe pensionet e kuptoni se ku është Kosova në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të Bashkimit Evropian. Me këta indikatorë ekonomikë dhe atë vetëm disa prej tyre që janë aktualisht në Kosovë - të thoni se Kosova ka zhvillimin më të madh ekonomik në Evropë nuk i bëni nder as Kosovës e as qytetarëve të saj. Kosova ka nevojë për kritik konstruktive që është në funksion të zhvillimit e jo për parashikime të segmentuara që më shumë irritojnë sesa që ndihmojnë.

## ARRESTOHET NJË PERSON, DYSHOHET SE ISHTE PJESË E NJË GRUPI QË FALSIFIKONTE DOKUMENTE

PRISHTINË, 24 PRILL - Një person është arrestuar më 23 prill dhe është dërguar në mbajtje, pasi dyshohet se ishte pjesë e një grupi që falsifikonte dokumente. "Sh. E. është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës dhe, me vendim të prokurorit të Prokurorisë Speciale, është dërguar në mbajtje për 48 orë", u tha në njoftimin e Policisë së Kosovës. Policia tha se muaj më parë kishte kryer një operacion ndaj grupit, kur kishte zbuluar dhe sekuestruar një sasi të madhe të dokumenteve të zbrazëta (blanko) të shteteve të ndryshme dhe pajisjeve që shërbejnë për prodhimin e



dokumente të falsifikuara. Në janar, sipas njoftimit, ishte

ndaluar një makinë me targa vendore, që drejtohej nga i

dyshuari F. K., e që gjatë kontrollit atij i ishte zbuluar

një sasi e madhe e dokumenteve të zbrazëta. "Pas hetimeve të mëtejme, në të njëjtën ditë, në një shtëpi të dyshuar në lagjen Veternik të Prishtinës është zbuluar një laborator i pajisur me makina të ndryshme laserike, printerë dhe pajisje të tjera që përdoren për prodhimin e dokumenteve të falsifikuara, si dhe dokumente blanko me kopertina të shteteve të ndryshme të Evropës dhe botës", tha policia. Hetimet për këtë rast, Policia e Kosovës i ka vazhduar me partnerët e saj ndërkombëtarë, përfshirë EUROPOL-in, që kanë rezultuar edhe me arrestimin e kryer më 23 prill.

## Osmani nderon Forcat e Armatosura të Finlandës me Medaljen Presidenciale Ushtarake

PRISHTINË, 24 PRILL - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani ka ndarë Medaljen Presidenciale Ushtarake për Forcat e Armatosura të Finlandës, në shenjë mirënjohjeje për kontributin dhe angazhimin tyre të palodhur në mbështetje të Kosovës që nga viti 1999, si pjesë e misionit të KFOR-it. Osmani në "Facebook" ka theksuar rëndësinë e rolit të

paqeruajtësve finlandezë, duke i quajtur "heronj të paqes, që veprojnë edhe atëherë kur është më e vështirë. "Në Pallatin Presidencial në Helsinki, kisha nderin ta ndajë Medaljen Presidenciale Ushtarake për Forcat e Armatosura të Finlandës, në shenjë mirënjohjeje për kontributin dhe angazhimin tyre e

palodhur në mbështetje të Kosovës, që nga viti 1999, si pjesë e misionit të KFOR-it. Paqeruajtësit janë heronjtë që bëjnë të mundur paqen, edhe kur është e vështirë. Faleminderit Finlandës dhe çdo ushtari finlandez për rolin e tyre të pazëvendësueshëm në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit!", ka shkruar Osmani.



## AKB-ja dhe bizneset e Kosovës marrin pjesë në Panairin e Ndërtimtarisë në Bursë

PRISHTINË, 24 PRILL - Një delegacion i bizneseve nga sektori i ndërtimtarisë, i udhëhequr nga kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, po merr pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Ndërtimtarisë që po mbahet në qytetin Bursë të Turqisë. Delegacioni përbëhet nga 40 përfaqësues të bizneseve të

Kosovës të cilët po zhvillojnë takime me përfaqësues të sektorit privat dhe institucional turk, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve. Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Bursës (BTSO), Ibrahim Burkay, i uroi mirëseardhje delegacionit nga Kosova dhe theksoi gatishmërinë për

bashkëpunim ekonomik me vendin tonë. Në emër të AKB-së, kryetari Agim Shahini i ftoi bizneset turke të investojnë më shumë në Kosovë, duke theksuar se Kosova është një vend i sigurt dhe atraktiv për investitorët, veçanërisht për ata nga Turqia, e cila mbetet një ndër partneret më të rëndësishme ekonomike të shtetit të Kosovës.



## PËRURORHET URA E RE NË ROGOVË TË HASIT

ROGOVË, HAS, 24 PRILL - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, bashkë me ministrin në detyrë të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, zëvendësministrin Hysen Durmishi dhe Jeton Raka, dhe dy deputetë të Kuvendit, Arbër Rexhaj e Artan Abrashi, përruruan të enjten urën në Rogovë të Hasit. Kryeministri Kurti falënderoi banorët e Rogovës për mikpritjen e përzemërt dhe i uroi për urën mbi lumin Drin me gjatësi të gjithmbarshme rreth 134 metra, që e lidh zonën e Hasit me rrugën Gjakovë - Prizren. “Në fund të vitit 2023 është nënshkruar kontrata, në prill të vitit 2024 kanë filluar punimet. E falënderojmë operatorin



ekonomik që ka përfunduar gjithçka brenda një viti. Dhe ja ku jemi tash, në prill të vitit 2025, po e lëshojmë në përdorim këtë urë e cila e ka gjerësinë 10 metra, prej tyre 6.5 metra është për automjete,

e 3.5 metra nga 1.75 metra në të dy anët, është për këmbësorë”, tha Kurti, i cili këtë urë e cilësoi lajm të mirë për të gjithë banorët e Rogovës dhe ata të cilët e vizitojnë. Ndërkaq ministri në detyrë i



Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, tha se ministria vazhdimisht i ka përcjellë punimet dhe realizimi i tyre është jashtëzakonisht një arritje e rëndësishme pasi jo

vetëm Rogova, por e gjitha zona e Hasit është e lidhur me rrugën Gjakovë - Prizren. Vlera e këtij projekti ka qenë 989 mijë euro dhe ka qenë kërkesë e kamotshme e banorëve të Hasit dhe zonave përreth.

## MURATI THOTË SE, SIPAS FMN-së, KOSOVA KËTË VIT DO TA KETË RRITJEN EKONOMIKE MË TË SHPEJTËN NË EVROPË

PRISHTINË, 24 PRILL - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se, sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, në vitin 2025 Kosova do ta ketë rritjen ekonomike më të shpejtën në Evropë. “Gjatë muajit të kaluar kisha nderin që në Prishtinë ta pres zëvendëspresidentin e Bankës Botërore, Akihiko Nishio, me rastin e tranzicionit të Kosovës në shtet donator në Bankën Botërore. Gjithashtu, kisha kënaqësinë të pres në takim edhe misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, udhëhequr nga shefi i misionit David Amaglobelli, në përmblyllje



të programit dyvjeçar të reformave të dakorduara me FMN-në. Në të dyja rastet, edhe Banka Botërore, edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, e përgëzuan Kosovën për reformat e ndërmarra, për performancën e mirë ekonomike dhe për maturinë fiskale. Rezultatet e punës së mirë katërvjeçare mund të mos shihen menjëherë, por sigurisht që herët a vonë do të vërehen. A jemi aty ku e kemi potencialin? Natyrisht që jo. Ka shumë punë për t'u bërë. Por, përkundër sfidave globale e pengesave vendore, do t'ia dalim”, ka thënë Murati.

## KRYETARI I RAHOVECIT THEMELON FOND PËR T'I SHPËRBLIER QYTETARËT QË RAPORTOJNË NDOTJEN MJEDISORE

RAHOVEC, 24 PRILL - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka themeluar një fond modest për t'i shpërblyer qytetarët që raportojnë ndotjen mjedisore me informata, me fotografi apo me video të bazuara në fakte. Kryetari Latifi ka thënë se raportimi i qytetarëve ndihmon në identifikimin e ndotësve dhe veprimi ndaj tyre është i menjëhershëm nga inspektorati. “Çdo raportim do të trajtohet me konfidencialitet të plotë. Emri dhe të dhënat tuaja mbeten të fshehta. Mos harroni: Sipas ligjit në fuqi: Gjohet për individë shkojnë nga 50 euro deri në 1,000 euro. Për biznese, gjobat arrijnë deri në 10,000 euro. Disa nga rastet që



mund të raportoni: Hedhje të mbeturinave në vende të palejuara; Ndotje të lumenjve apo të pyjeve; Djegie të mbeturinave; Dëmtime të hapësirave të gjelbra. Shpërblimi është modest, por ndikimi është i madh! Bëhuni pjesë e mbrojtjes së natyrës sonë. Bashkë për një Rahovec më të pastër dhe më të gjelbër!”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.

## Totaj pret në takim ndërmarrësin Isak Neziri, diskutojnë për sjelljen e investimeve ndërkombëtare në Kosovë

PRIZREN, 24 PRILL - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim ndërmarrësin shqiptar të suksesshëm në Gjermani, Isak Neziri. Totaj ka treguar se Neziri po bën përpjekje për sjelljen e investimeve ndërkombëtare në Kosovë,

respektivisht në komunën e Prizrenit, që janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik jo vetëm për Prizrenin, por për gjithë rajonin. “Krijimi i mundësive të reja për punësim dhe avancim të infrastrukturës, si dhe

bashkëpunimi me ndërmarrës të suksesshëm nga mërgata shqiptare e ata të huaj, mund të sjellë një model të ri të zhvillimit, i cili do të ndihmonte në ngritjen e cilësisë së jetës dhe standardit të qytetarëve tanë”, ka thënë Totaj.



# NJIHUNI ME PRONAT MARRAMENDËSE TË VATIKANIT



Gazeta financiare franceze Les Echos shkroi në vitin 2020: “Të varfërit janë thesari i Kishës”, me rastin e Ditës Botërore të të Varfërve. Por ata sigurisht nuk do të vendosen në një nga 49 apartamentet luksoze që do të ndërtohen në lagjen Chelsea të Londrës, në 60 Sloane Avenue, e cila i përket pronës së Vatikanit falë një investimi prej 200 milionë dollarësh të bërë në vitin 2014. Një vit pas zgjedhjes, Papa Françesku premtoi një “kishë të varfër në shërbim të një bande të varfër shtetërore”, por.... Vatikani ka një histori të gjatë investimi në sektorin bankar dhe atë të sigurimeve, me synimin për të siguruar dhe rritur burimet e tij financiare për të mbështetur aktivitetet e tij fetare dhe bamirëse. Investimet bankare të Vatikanit ndahen në dy kategori institucionale: -Instituti për Punët Fetare (IOR): I njohur gjithashtu si

Banka e Vatikanit, IOR u themelua në vitin 1942 dhe operon si një institucion financiar i pavarur brenda Vatikanit. Ajo menaxhon asetë prej 5.38 miliardë eurosh dhe u shërben kryesisht institucioneve katolike dhe klerikëve. Në vitin 2023, IOR raportoi fitime neto prej 30.59 milionë euro. -Administrimi i pronës së Selisë Apostolike (APSA): APSA funksionon si thesari dhe banka qendrore e Vatikanit, duke menaxhuar investimet në aksione, pasuri të paluajtshme dhe aktive të tjera. Në vitin 2023, vlera totale e asetëve nën menaxhim vlerësohej në mbi 2.7 miliardë euro. Vatikani ka investime të konsiderueshme në aksione, kryesisht në Itali, por edhe në vende të tjera. Në bursën italiane, portofoli me vlerë 1.6 miliardë dollarë përfshin investime në sektorë si banka, sigurimet, industria kimike,

çeliku dhe ndërtimi. Papa Françesku promovoi reforma për një transparencë më të madhe në menaxhimin financiar dhe në vitin 2023 shtetëzoi të gjitha asetet e departamenteve të ndryshme të Vatikanit, duke i transferuar ato nën ombrellën e menaxhimit qendror të Selisë së Shenjtë.

## Kozmopolitizmi i pasurive të paluajtshme

Vatikani zotëron mbi 5000 prona në mbarë botën, sipas njoftimeve të para zyrtare të bëra në vitin 2021 nga Administrata e Pronave të Selisë Apostolike (APSA). Në detaje, zotëron 4051 prona në Itali dhe afërsisht 1120 në vende të tjera, duke përfshiruar ambasadat. Shumica e pasurive të saj të paluajtshme janë të vendosura në Romë me rreth 3000 prona. Shumë prej tyre u

jepen me qira punonjësve të Kishës me qira të reduktuara ose përdoren për qëllime fetare dhe sociale, si shkolla, spitale dhe manastire. -Në Londër, Vatikani zotëron 27 prona në zona si Sheshi St. James, Kensington dhe New Bond Street, me një vlerë totale prej rreth 108.5 milionë euro. -Në Paris, APSA administron 737 prona në zona si Bulevardi Saint-Michel, Odéon dhe Champs-Élysées, me një sipërfaqe totale prej gati 56,000 metra katrorë dhe një vlerë rreth 595.5 milionë euro. -Në Zvicër, kryesisht në Gjenevë dhe Lozanë, Vatikani zotëron 140 prona me një sipërfaqe totale prej 16 mijë metrash katrorë dhe një vlerë prej më shumë se 91 milionë euro. Përveç vendeve të mësipërme, Vatikani zotëron prona edhe në qytete të tjera, si në Nju Jork, ndonëse detaje rreth këtyre zonave nuk janë bërë

publike. Vlen të përmendet se Pallati i Castel Gandolfo, pallati veror papal, gjithashtu i përket Vatikanit dhe është shndërruar në muze që nga viti 2016. Sa i përket investimeve në sigurime, ajo që dimë është se Bernardino Nogara, menaxher financiar i Vatikanit në vitet 1930, investoi ndjeshëm në kompaninë e sigurimeve Assicurazioni Generali, më e madhja në Itali. Këto investime ndihmuan në forcimin e financave të Vatikanit. Gjurma e vërtetë e pranisë së Papa Françesku ish-instituti për reformat për transparencë dhe etikë më të madhe në investimet e Vatikanit. Për më tepër, vlen të theksohet se Vatikani zotëron vepra të paçmuara të artit dhe trashëgimisë kulturore, të tilla si Kapela Sistine si dhe vepra të Michelangelo dhe Raphael, të cilat nuk vlerësohen komercialisht.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Gjakova dhe Cena eliminohen nga Kampionati Evropian

PODGORICË, 24 PRILL - Xhudistët tanë, Akil Gjakova dhe Dardan Cena, ishin të pafat, pasi u eliminuan në faza të ndryshme në garat deri në 73 kilogramë në Kampionatin Evropian të Xhudos që po mbahet në Podgoricë të Malit të Zi. Akil Gjakova i nisi garat mirë

duke fituar në fazën e 1/16-s ndaj francezit Maxime Gobert, ndërsa u kualifikua në çerekfinale pasi në 1/8-n mposhti me një "ippon" xhudistin nga Moldavia, Victor Serpu. Megjithatë, në çerekfinale ishte i pafat pas një lufte të madhe me gjeorgjianin Lasha

Shavdatiashvili, ku u mposht, për t'i vazhduar garat me anë të repesazhit. Në ndeshjen e parë të repezazhit, Gjakova u ndal nga hungarezi Daniel Szegedi, i cili e mposhti me 'ippon', duke ia pamundësuar medaljen e bronzit. I pafat të enjten ishte edhe xhudisti tjetër Dardan Cena, i cili u

eliminua në luftën e tretë nga rusi Danile Lavrentev. Në raundin e parë, Cena mposhti izraelitin Baruch Shmailov, ndërsa në raundin e dytë triumfoi ndaj Said-Magomed Khalidov. Vlen të theksohet se të mërkurën Distria Krasniqi fitoi medaljen e artë të



Kampionatit Evropian në kategorinë deri në 52 kilogramë.

# Katër klube synojnë Kupën në Hendboll

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 PRILL - Të shtunën do të zhvillohet "Final 4" i Kupës së Kosovës në Hendboll në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj. Gjysmëfinalja e parë do të zhvillohet nga ora 16:00 në mes të Vushtrrisë e Besa Famgasit. Hendbollisti Egzon Ademi, që është prej lojtarëve më të rëndësishëm në Klubin e Vushtrrisë, ka thënë se janë të vetëdijshëm për forcën e Besës, por se janë të vendosur për të dhënë më të mirën në kërkim të suksesit. "Klubi ynë rikthehet pas shumë vjetësh në mesin e katër skuadrave më të mira në garën për Kupë të Kosovës. Kjo është një e arritur e madhe për ne dhe për gjithë qytetin. Është po ashtu një mundësi e artë për të treguar punën dhe përkushtimin që kishim gjatë gjithë këtij edicioni garues. Jemi të përgatitur që në këtë ndeshje të japim maksimumin në fushën e lojës, edhe pse jemi të

vetëdijshëm që kundërshtari ynë është prej ekipeve më të mira në Kosovë dhe atë për kohë shumë të gjatë. Nuk do të dorëzohemi dhe do të tregojmë vlerat tona, ndonëse e dimë që na pret një ndeshje e fortë", ka thënë Ademi. Në anën tjetër, hendbollisti i Besa Famgas, Olsi Mulaj, ka bërë me dije se klubi pejan synim e ka triumfin në garën e Kupës. "Kemi punuar fort gjatë gjithë edicionit dhe kemi qenë të përkushtuar për të arritur objektivat tona. Synimi ynë në turneun final të Kupës është i qartë: të japim maksimumin në çdo ndeshje, të tregojmë lojën tonë më të mirë dhe të luftojmë për të fituar Kupën e vlefshme të Kosovës. E dimë që gara do të jetë e fortë dhe se çdo skuadër që ka arritur në fazën gjysmëfinale e meriton respektin tonë. Por në të njëjtën kohë ne kemi shumë besim në grupin tonë dhe në punën që kemi bërë. Ftojme të gjithë adhuruesit e hendbollit të jenë



pranë nesh në këtë turne dhe të shijojnë ndeshje të nivelit të lartë", ka thënë Mulaj. Ndeshja tjetër pritet të jetë shumë interesante. Do të përballen Kastrioti dhe Rahoveci nga ora 20:00. Aloja Lulzim Shabani është prej "armëve" kryesore të Kastriotit. Ai është optimist se Kupa do të mbetet në Ferizaj. "Përgatitjet janë duke shkuar shumë mirë. Ka kohë që kemi menduar për këtë 'Final 4' dhe jemi

përgatitur maksimalisht. Skuadra është në gjendje jashtëzakonisht të mirë fizike, e po ashtu në anën psikologjike jemi shumë të përgatitur dhe të vendosur që edhe këtë vit ta stolisim qytetin me trofeun e çmuar të Kupës së Kosovës. Do të jetë më e veçantë pasi turneu final organizohet në qytetin tonë, në qytetin e hendbollit. Premtojmë spektakël, duela të forta e shumë lojë të bukur për të gjithë sportdashësit që do të

jenë në 'Bill Clinton'. I ftoj gjithë qytetarët ferizajas dhe tifozët tanë 'Ujqit' që të na mbështesin në mënyrë masovike dhe si gjithmonë të tregojnë kulturë e mbështetje korrekte për ekipin tonë", ka deklaruar Shabani. Pritjet janë të mëdha edhe për hendbollistin e Rahovecit, Mali Luzha. "Jemi të motivuar maksimalisht për të dhënë më të mirën në turneun e Kupës së Kosovës. Kjo garë është e rëndësishme për ne dhe e shohim si një mundësi të madhe për të treguar kualitetin dhe forcën tonë si skuadër. Forma jonë e deritashme, ku nuk kemi pësuar asnjë humbje gjatë gjithë edicionit në Superligë, është dëshmi e përkushtimit dhe punës së palodhshme të ekipit, stafit dhe gjithë klubit. Kjo na jep dhe motiv shtesë për të synuar trofeun e Kupës", ka thënë Luzha. Krahas "Final 4" te meshkujt, në fundjavë zhvillohet edhe "Final 4" në konkurrencën e femrave.

## Krasniqi: Të shpallesh tri herë kampione evropiane nuk është e lehtë



PRISHTINË, 24 PRILL - Distria Krasniqi të mërkurën e ka fituar titullin e kampiones së Evropës për herë të tretë në karrierën e saj. Medalistja e dyfishtë olimpike fitoi medaljen e artë në Kampionatin Evropian të Xhudos që po mbahet në Podgoricë të Malit të Zi. Në finalen plot emocione, Krasniqi mundi italianen Odette Giuffrida, kategoria - 52 kg. "Po ndihem shumë e lumtur, ka qenë shumë e vështirë për ta marrë këtë medalje sepse është

më lehtë të merret për herë të parë sesa të përsëritet një rezultat. Është hera e tretë që po bëhem kampione evropiane. Jam shumë e lumtur dhe është shumë medalje e veçantë për mua pasi është kampionati i parë evropian pas Lojërave Olimpike dhe kjo shihet se jam ende e motivuar për të vazhduar me të njëjtin ritëm siç kam qenë para Lojërave Olimpike", ka thënë Krasniqi. "Ishte e vështirë shumë, sidomos me xhudistët që jam

ndeshur sot prej luftës së parë deri në finale me italianen kështu që ka qenë një ditë shumë e vështirë, shumë e lodhshme, por gjithçka ka shkuar mirë dhe e kam pasur një performancë shumë të mirë dhe të gjitha ato përgatitje janë shpërblyer", ka shtuar Krasniqi, e cila qysh tani ka filluar përgatitjet për Kampionatin Botëror të Xhudos i cili mbahet pas dy muajsh në Budapest. Synimi i tij është që edhe aty të rrëmbejë medalje.


## Shaqiri: Në fushë jam shqiptar, në jetë zviceran

BASEL, 24 PRILL - Ylli i Baselit, Xherdan Shaqiri, ka treguar së fundmi se karakteri i tij është i kombinuar mes atij shqiptar dhe zviceran. Shaqiri ka folur për median 'blu Sport' për fëmijërinë e tij të vështirë,

luksin e mëvonshëm, popullaritetin dhe ëndrrën e tij më të madhe: ta fitojë trofeun me Baselin. Megjithatë, ajo çfarë na intereson nga kjo intervistë ishte përgjigja e tij në pyetjen se a ka më shumë

karakter zviceran apo shqiptar. "Në fushë, padyshim shqiptari i pasionuar – me emocione. Megjithatë, në jetën e përditshme jam shumë zviceran: i përpiktë, i besueshëm. Mendoj se i

kombinoj të dyja mentalitetet", ka thënë Shaqiri për mediumin zviceran. Shaqiri është duke përjetuar një edicion të përkryer me Baselin, pasi ka 16 gola dhe 18 asistime nga 32 ndeshje.



## Fitojnë Clevelandi e Bostoni, Houstoni barazon serinë me Golden State

OHIO, 24 PRILL - Clevelandi udhëheq 2-0 serinë e ndeshjeve çerekfinale “play-off” në Konferencën e Lindjes ndaj Miamit pas fitores me rezultat 121-112. Ndeshje e dominuar nga Cavaliersi, ku u dallua Donovan Mitchell

me 30 pikë. Tyler Herro realizoi 33 pikë për Miamin, por që s’mjaftuan për të fituar. Po 2-0 udhëheq serinë e çerekfinaleve edhe ekipi i Bostonit, që triumfoi me rezultat 109-100 ndaj Orlandos. Sfidë e mirë e

kampionëve në fuqi, që i shfrytëzuan në maksimum dy ndeshjet në shtëpi. Jaylen Brown me 36 pikë ishte lider në fushë për Celticsin, ndërsa 32 pikët e Bancheros për miqtë mbetën për statistikë. Në Konferencën e Perëndimit

ekipi i Houstonit fitoi me rezultat 109-94 ndaj Golden States, duke barazuar 1-1 serinë e takimeve. Curry me 20 pikë u dallua për miqtë, por ishte i pambështetur nga shokët e ekipit. Jalen Green me 38 pikë bëri



diferencën në fushë për Houstonin.

## Erëleta Memeti: Synojnë suksese me Eintracht Frankfurtin

FRANKFURT, 24 PRILL - Erëleta Memeti është transferuar në Eintracht Frankfurt, të cilit do t’i bashkohet nga vera. Përfaqësuesja e Kosovës do t’i japë fund përvojës në TSG Hoffenheim, ndërsa ka nënshkruar me SGE deri më 30 qershor të vitit 2027, ka njoftuar klubi gjerman. Pasi i ka kaluar katër vjet dhe i bëri 71 paraqitje në 2. Frauen-Bundesliga (divizioni i dytë i Bundesligës) me VfL Sindelfingen dhe me VfL Wolfsburg II, 25-vjeçarja i ishte bashkuar SC Freiburgut në sezonin 2020/21, ku i kishte kaluar dy sezone para se të lëvizte drejt TSG Hoffenheimit për tri vjet të tjerë, përfshirë këtu edhe sezonin aktual. Ajo i ka zhvilluar në total 100 ndeshje në Bundesligë me dy klubet, duke i realizuar 23 gola, ndërsa i ka shtuar edhe 10 gola në 16 ndeshje në DFB-Pokal, ku vlen të përmendet goli vendimtar kundër Wolfsburgut në çerekfinalen e mes-shkurtit. E lindur në Schwabisch Hall, futbollistja ofensive kishte bërë përparim vazhdimisht duke luajtur për ekipet zinxhirë të Gjermanisë, nga U-16 deri në U-20, ku i kishte luajtur tri ndeshje të



raundit preliminar për në Kupën e Botës U-20 në vitin 2018. Memeti më pas vendosi të luajë për ekipin A të Kombëtares së Kosovës, ku tash është kapitene. Dy vjet më parë ajo ishte zgjedhur futbollistja më e mirë e vitit në Kosovë. “Nëse kthehemi disa sezone më parë, tash mund ta shohim qartë se Eintracht Frankfurti është zhvilluar në një top-klub. Stili dhe qasja e ekipit të Niko Arnautis i përshtatet perfekt shpejtësisë dhe stilit tim dinamik. Jam e bindur se mund ta ndihmoj ekipin me kualitetet e mia. Synimi im është të konkurrojmë për kreun e tabelës me Eintrachtin në vitet e ardhshme dhe t’i sfidojmë seriozisht Wolfsburgun e

Bayernin. Jam mjaft e ngazëllyer që jam pjesë e këtij klubi ambicioz duke filluar nga vera që po vjen”, deklaroi përfaqësuesja e Kosovës. Edhe drejtuesit e klubit i kanë uruar mirëseardhje Memetit, ndërsa drejtoresha teknike, Katharina Kiel, tha se pret shumë nga futbollistja e Kosovës, që me kualitetet dhe përvojën e saj ta ndihmojë klubin e saj të ri. Gjithashtu, edhe trajneri dhe drejtori sportiv Niko Arnautis mezi pret ta nisë punën me Erëleta Memetin, për të cilën thotë se ekipi i tij kishte nevojë dhe se pret shumë që ajo të japë kontribut të madh në Eintracht Frankfurt.

## Vardy largohet nga Leicesteri pas 13 vjetëve

LEICESTER, 24 PRILL - Kapiteni i Leicester Cityt, Jamie Vardy, do të largohet nga klubi në fund të këtij sezoni, pas 13 vjetëve. Sulmuesi anglez e dha lajmin përmes kanaleve zyrtare të klubit, derisa nga skuadra ai u quajt “lojtari më i madh në histori të klubit”. 38-vjeçari, i cili iu bashkua Leicesterit në vitin 2012 nga ekipi i ligës joprofesionale, Fleetwood Town, është golashënuesi më i mirë i klubit me 198 gola në 498 paraqitje në të gjitha garat. Vardy shënoi 24 gola gjatë sezonit 2015-16 të Premierë Ligës, duke e ndihmuar Leicesterin ta fitonte titullin e parë në historinë e klubit. Ish-lojtari i kombëtares së Anglisë ishte pjesë e skuadrës që



fitoi Kupën e Anglisë në vitin 2021, kur “Dhelprat” e mposhtën Chelsea 1-0 në Wembley. “Fansa të Leicesterit, jam i dëshpëruar që kjo ditë po vjen, por e dija që do të ndodhte një ditë”, ka thënë Vardy në një video

të postuar nga Leicesteri në rrjetet sociale. “Kam kaluar 13 vjet të pabesueshme në këtë klub, me shumë suksese, dhe disa ulje, por shumica kanë qenë kulme. Është koha e duhur për ta mbyllur këtë kapitull dhe jam i dëshpëruar për këtë, por mendoj se koha është e duhur. Leicesteri do të ketë gjithmonë një vend të madh në zemrën time”, ka shtuar ai. Vardy i mbeti besnik ekipit kur kishte rënë nga liga në vitin 2023, por duke e ndihmuar të kthejë shpejt në Premierë Ligë në vitin 2024. Megjithëse shënoi vetëm shtatë gola në 30 paraqitje në ligë këtë sezon, Leicesteri javën e kaluar ra sërish nga liga, duke grumbulluar vetëm 18 pikë nga 33 ndeshje.

### SHKURT

#### Fidel Ylli konfirmohet në krye të KOKSh-it

Fidel Ylli është konfirmuar president i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Ai u rizgjidh kreu i KOKSh-it për një mandat tjetër katërvjeçar në asamblenë e mbajtur këtë të mërkurë. Ylli ishte kandidati i vetëm për president. Fidel Ylli mori 64 vota për dhe 3 kundër. Në këtë assemble mungoi Federata Shqiptare e Futbollit, pasi nuk u përfshi në rendin e ditës, një vendim i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit Sportiv që përmbyste vendimet e marra gjatë Asamblesë së Jashtëzakonshme KOKSh-it të mbajtur më 10 janar 2021. Në anën tjetër Komiteti Olimpik Shqiptar ka njoftuar se ankesa e FShF-së nuk është pranuar më pas nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

#### Figó: PSG-ja është favorite në Ligën e Kampionëve

Legjenda e futbollit portugez dhe e Real Madridit, Luis Figó, u shpreh se Paris Saint-Germain është favorit në Ligën e Kampionëve. “Gjysmëfinalja PSG-Arsenal? Për mua, Paris Saint-Germain është favorit. Është në një seri të rregullt rezultatesh dhe fizikisht është në formë shumë të mirë, por është e vështirë të bësh parashikime. Nuk më pëlqen të them me siguri kush do ta fitojë. Barcelona-Iner- janë dy skuadra me stile të ndryshme, por Interi nuk është thjesht një ekip mbrojtës. Kush mendon kështu, gabon. Është një skuadër shumë solide në mbrojtje – ka pësuar shumë pak gola në Ligën e Kampionëve – por ka edhe lojtarë që bëjnë diferencën. Prandaj duhet bërë një analizë më e plotë, jo thjesht ta quajmë ekip mbrojtës”, ka thënë Figó.

#### Conceição: Nuk kemi fituar asgjë

Trajneri i AC Milan, Sergio Conceição, është shprehur i kënaqur me fitoren e arritur ndaj rivalëve të Interit (0-3), por ka thënë se skuadra kuqezi ende nuk ka fituar asgjë. “Nuk kemi fituar ende asgjë. Është ende një finale për t’u luajtur, gjithashtu është një fund sezoni ku duhet të bëjmë më mirë për ta ndryshuar imazhin e këtij Milani. E ardhmja ime? Nuk është aspak e rëndësishme. E rëndësishme është të fitojmë kundër Venezas dhe të fitojmë finalen në Romë”, u shpreh trajneri i Milanit.

#### Inzaghi kërkon përkrahjen e tifozëve dhe klubit para ndeshjeve vendimtare

Interi është eliminuar nga Kupa pasi humbjes në derbi ndaj Milanit (0-3), duke shuar ëndrrën për “tripletën” e famshme. Të eliminoresh në këtë formë pa diskutim që i lë një shije të hidhur trajnerit Simone Inzaghi. Interi vazhdon të jetë në garë për Serinë A dhe Ligën e Kampionëve. “Të vjen keq, mbi të gjitha pas një pjesë të parë ku meritoni diçka më shumë. Duhet të ishim treguar më të zotë, t’i shfrytëzonim shanset që krijuam, ndërsa Milan na goditi në rastin e parë me një gol të bukur. Sigurisht, i duhen bërë komplimente edhe Milanit, në të pesë derbit na ka vendosur në vështirësi. Të gjithë duhet të kishim bërë diçka më shumë. Unë i pari. Lodhja ndihet, por kjo nuk duhet të jetë një alibi. Si mund të rikuperohejmë pas një humbje të tillë? Na pret një muaj i fundit, ai më i rëndësishmi. Duhet ta përballojmë me besim dhe me mbështetjen e të gjithëve, tifozëve dhe shoqërisë”, u shpreh Inzaghi.

## Courtois: Tifozët e Realit do të festojnë në finale ndaj Barçës

Real Madridi, pasi e mposhti Getafën, po mendon për finalen e Copa del Rey ndaj Barcelonës. Portieri Thibaut Courtois në konferencë për shtyp për “El Clasicón” e së

shtunës tregoi se çka i nevojitet “Los Blancos” për të triumfuar. “Është e rëndësishme ta mbajmë portën e paprekur. Është gjithmonë pozitive të kemi

soliditet në mbrojtje dhe këtë do ta mbajmë nëse të gjithë do të koncentrohen te mbrojtja. Është ajo që e kemi bërë në ndeshjet e fundit dhe këtë duhet ta bëjmë edhe të

shtunën në finalen e Kupës”, ka thënë Courtois. “Finalja e Copa del Rey? Duhet të jemi të koncentruar. Jemi vërtet të emocionuar për finalen e Copa del Rey. Humbëm në Ligën e

Kampionëve dhe jemi të dytët në La Liga, por duam t’u japim tifozëve të Real Madridit diçka për të brohoritur dhe festuar kundër Barcelonës në finalen e Kupës”, ka shtuar Courtois.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gieipuneshpeite](http://www.facebook.com/gieipuneshpeite)

# RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Red Taxi” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811381805 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Red Taxi" D.O.O. Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811381805 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Red Taxi” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811381805 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enver Xhiha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Medresesë "Alaudin" në Prishtinë.

- Fatlum Leci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheydet Doda" Prishtinë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Haidar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme  
na kontaktoni në numrin  
e telefonit: 044-162-783.


- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër  
prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej:  
60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sal-  
lon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet.  
Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për  
afate të gjata dhe të shkurtra.  
Informata në tel: 049\44-888-801  
(viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Mendon për ty!

| Bilanci i gjendjes me: 31/03/2025                    | Euro '000                        |                                |
|------------------------------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
|                                                      | Tremujori paraprak<br>31/12/2024 | Tremujori vijues<br>31/03/2025 |
| <b>Pasuritë</b>                                      |                                  |                                |
| Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në               | 78,309                           | 59,145                         |
| Kërkesat ndaj bankave                                | 22,407                           | 23,012                         |
| Bonot e thesarit                                     | 0                                | 0                              |
| Investimet në letra me vlerë                         | 55,749                           | 60,498                         |
| Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve               | 491,220                          | 497,536                        |
| Patundshmëritë dhe pajisjet                          | 14,271                           | 13,670                         |
| Pasuritë e paprekshme                                | 2,470                            | 2,532                          |
| Pasuritë tatimore të shtyra                          | 0                                | 0                              |
| Pasuritë tjera                                       | 10,855                           | 9,804                          |
| <b>Gjithsej pasuritë</b>                             | <b>675,281</b>                   | <b>666,196</b>                 |
| <b>Detyrimet</b>                                     |                                  |                                |
| Depozitat e klientëve                                | 596,936                          | 583,768                        |
| Detyrimet ndaj bankave                               | 1,096                            | 2,503                          |
| Fondet tjera të huazuara                             | 0                                | 0                              |
| Detyrimet tatimore të shtyra                         | 0                                | 0                              |
| Detyrimet tjera                                      | 4,527                            | 4,315                          |
| <b>Gjithsej detyrimet</b>                            | <b>602,559</b>                   | <b>590,586</b>                 |
| <b>Ekuiteti i aksionarëve</b>                        |                                  |                                |
| Kapitali aksionar                                    | 29,422                           | 29,422                         |
| Rezervat e kapitalit                                 | 4,774                            | 4,854                          |
| Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake        | 27,833                           | 38,529                         |
| Fitimi/(humbja) e vitit aktual                       | 10,694                           | 2,805                          |
| Përbërësit tjerë të ekuitetit                        | 0                                | 0                              |
| <b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>               | <b>72,722</b>                    | <b>75,610</b>                  |
| <b>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve</b> | <b>675,281</b>                   | <b>666,196</b>                 |

www.bekonomike.com | info@bekonomike.com  
+383 (0) 38 500 500 | +383 (0) 49 73 33 22

| Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31/03/2025 | Euro '000                        |                                |
|-------------------------------------------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
|                                                                   | Tremujori paraprak<br>31/12/2024 | Tremujori vijues<br>31/03/2025 |
| Të hyrat nga interesi                                             | 35,971                           | 9,488                          |
| Shpenzimet e interesit                                            | (7,678)                          | (1,910)                        |
| <b>Neto të hyrat nga interesi</b>                                 | <b>28,293</b>                    | <b>7,578</b>                   |
| Të hyrat nga tarifat dhe komisionet                               | 6,293                            | 1,584                          |
| Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve                             | (1,812)                          | (905)                          |
| <b>Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet</b>                   | <b>4,480</b>                     | <b>679</b>                     |
| Neto të hyrat nga tregtimi                                        | 155                              | 35                             |
| Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare                   | 375                              | 24                             |
| Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative                        | (18,995)                         | (4,464)                        |
| <b>Gjithsej të hyrat</b>                                          | <b>14,308</b>                    | <b>3,852</b>                   |
| Provizionet për humbjet nga kreditë                               | (2,652)                          | (735)                          |
| Fitimi/(humbja) para tatimit                                      | 11,657                           | 3,117                          |
| Shpenzimet e tatimit në fitim                                     | (963)                            | (312)                          |
| <b>Fitimi/(humbja) neto</b>                                       | <b>10,694</b>                    | <b>2,805</b>                   |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse                               | 21                               | 60                             |
| <b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>                     | <b>10,714</b>                    | <b>2,865</b>                   |



Mendon për ty!

| Bilanci i gjendjes me: 31/12/2024                    | Euro '000                        |                                |
|------------------------------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
|                                                      | Tremujori paraprak<br>30/09/2024 | Tremujori vijues<br>31/12/2024 |
| <b>Pasuritë</b>                                      |                                  |                                |
| Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në               | 57,024                           | 78,309                         |
| Kërkesat ndaj bankave                                | 27,488                           | 22,407                         |
| Bonot e thesarit                                     | 0                                | 0                              |
| Investimet në letra me vlerë                         | 62,093                           | 55,749                         |
| Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve               | 484,317                          | 491,220                        |
| Patundshmëritë dhe pajisjet                          | 14,514                           | 14,271                         |
| Pasuritë e paprekshme                                | 2,018                            | 2,470                          |
| Pasuritë tatimore të shtyra                          | 0                                | 0                              |
| Pasuritë tjera                                       | 11,644                           | 10,855                         |
| <b>Gjithsej pasuritë</b>                             | <b>659,097</b>                   | <b>675,281</b>                 |
| <b>Detyrimet</b>                                     |                                  |                                |
| Depozitat e klientëve                                | 538,904                          | 596,936                        |
| Detyrimet ndaj bankave                               | 582                              | 1,096                          |
| Fondet tjera të huazuara                             | 0                                | 0                              |
| Detyrimet tatimore të shtyra                         | 0                                | 0                              |
| Detyrimet tjera                                      | 4,476                            | 4,527                          |
| <b>Gjithsej detyrimet</b>                            | <b>588,962</b>                   | <b>602,559</b>                 |
| <b>Ekuiteti i aksionarëve</b>                        |                                  |                                |
| Kapitali aksionar                                    | 29,422                           | 29,422                         |
| Rezervat e kapitalit                                 | 4,653                            | 4,774                          |
| Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake        | 27,833                           | 27,833                         |
| Fitimi/(humbja) e vitit aktual                       | 8,227                            | 10,694                         |
| Përbërësit tjerë të ekuitetit                        | 0                                | 0                              |
| <b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>               | <b>70,135</b>                    | <b>72,722</b>                  |
| <b>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve</b> | <b>659,097</b>                   | <b>675,281</b>                 |

www.bekonomike.com | info@bekonomike.com  
+383 (0) 38 500 500 | +383 (0) 49 73 33 22

| Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31/12/2024 | Euro '000                        |                                |
|-------------------------------------------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|
|                                                                   | Tremujori paraprak<br>30/09/2024 | Tremujori vijues<br>31/12/2024 |
| Të hyrat nga interesi                                             | 26,578                           | 35,971                         |
| Shpenzimet e interesit                                            | (5,600)                          | (7,678)                        |
| <b>Neto të hyrat nga interesi</b>                                 | <b>20,979</b>                    | <b>28,293</b>                  |
| Të hyrat nga tarifat dhe komisionet                               | 4,690                            | 6,293                          |
| Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve                             | (1,361)                          | (1,812)                        |
| <b>Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet</b>                   | <b>3,329</b>                     | <b>4,480</b>                   |
| Neto të hyrat nga tregtimi                                        | 135                              | 155                            |
| Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare                   | 356                              | 375                            |
| Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative                        | (13,178)                         | (18,995)                       |
| <b>Gjithsej të hyrat</b>                                          | <b>11,620</b>                    | <b>14,308</b>                  |
| Provizionet për humbjet nga kreditë                               | (2,480)                          | (2,652)                        |
| Fitimi/(humbja) para tatimit                                      | 9,141                            | 11,657                         |
| Shpenzimet e tatimit në fitim                                     | (914)                            | (963)                          |
| <b>Fitimi/(humbja) neto</b>                                       | <b>8,227</b>                     | <b>10,694</b>                  |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse                               | (117)                            | 21                             |
| <b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>                     | <b>8,110</b>                     | <b>10,714</b>                  |





ROYAL CROWN

**RC**  
cola

# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1906

Columbus, Georgia, USA  
Since 1906 0.5L

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

